



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



OSMANI: VAZHDIMI I MASAVE TË BE-së NDAJ KOSOVËS, I PASHPJEGUESHËM DHE I PADREJTË



Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se vazhdimi i masave ndëshkuese që Bashkimi Evropian ka vendosur ndaj vendit mbetet "i pashpjegueshëm, i padrejtë dhe i paarsyeshëm". Gjatë një takimi me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, Osmani kërkoi mbështetjen e tij për

heqjen e këtyre masave që blloku evropian i ka vendosur më 2023. Ndërkaq në një takim që ka pasur të martën ambasadori i Francës, Olivier Guerot, me kryetarin e PDK-së, Bedri Hamza, ka bërë me dije se letra e këtij të fundit për masat e BE-së ndaj Kosovës i është dorëzuar kabinetit të Macronit

AKTUALE



**ZELENSKY PËRJASHTON
MUNDËSINË E LËSHIMEVE
TERRITORIALE F. 2**

**PËRPARIM RAMA BETOHET NË
MANDATIN E DYTË KRYETAR I
PRISHTINËS F. 3**

**VITIA NJOFTON PËR SHPËRNDARJEN
EDHE TË TETË AUTOAMBULANCAVE
TË REJA NËPËR KOMUNA F. 3**

EKONOMI



**AKTAKUZË NDAJ TRE
PERSONAVE PËR SHPËRTHIMIN
NË IBËR-LEPENC F. 8**

**KURTI: NGA 1 JANARI PAGA
MINIMALE BËHET 425 EURO F. 8**

SPORT



**FIFA ARENA TASHMË EDHE NË
KOSOVË F. 11**

**MOSRESPEKTIMI
I PROTOKOLLEVE
NË QKUK RRI
INFEKSIONET F. 7**



**OVLUÇK-ja FTON
SHQIPTARËT
TË BASHKOHEN
NË PROTESTËN
E 13 DHJETORIT
NË SHKUP F. 7**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY PËRJASHTON MUNDËSINË E LËSHIMEVE TERRITORIALE

LONDËR, 9 DHJETOR - Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky tha më 8 dhjetor se Kiev i "nuk ka të drejtë morale" t'i japë territor Moskës teksa Uashingtoni kërkon kompromise. "Sipas ligjit ukrainas, Kushtetutës apo ligjit ndërkombëtar, ne nuk kemi të drejtë ligjore. Ne nuk kemi të drejtë morale, po ashtu", tha Zelensky gjatë një takimi online më 8 dhjetor, kur u pyet nëse Kiev po e shqyrton mundësinë që të dorëzojë territor. "Sigurisht, Rusia insiston që ne të heqim dorë nga territori. Sigurisht që ne nuk duam të dorëzojmë asgjë. Për këtë ne po luftojmë", shtoi ai. Duke komentuar draft-propozimin për paqe të ShBA-së, Zelensky tha se ai është reduktuar në 20 pika dhe pikat që haptazi ishin antiukrainase janë hequr. "Ishin 28 pika, tani

janë 20. Pikat që haptazi ishin antiukrainase janë hequr. Amerikanët janë, në parim, për gjetje të një kompromisi. Sigurisht, ka çështje të ndërlikuara sa i përket territorit. Deri më tani nuk është gjetur ndonjë kompromis", tha Zelensky. Zelensky shkroi në X pas takimit të tij më 8 dhjetor në Londër me kryeministrin britanik, Keir Starmer, presidentin francez Emmanuel Macron dhe kancelarin gjerman Friedrich Merz, se ai i kishte "informuar mbi kontaktet tona me Shtetet e Bashkuara dhe mbi punën për të gjitha propozimet që aktualisht janë në tryezë". "Është e rëndësishme që të punojmë së bashku mbi të gjitha dokumentet, përfshirë kornizën e përgjithshme të paqes, garancitë e sigurisë dhe



rimëkëmbjen e Ukrainës pas luftës", theksoi ai. "Fati i Ukrainës është fati i Evropës", shkroi në rrjetet sociale kancelari gjerman Friedrich Merz. "Askush nuk duhet të ketë asnjë dyshim: Mbështetja jonë nuk do të dobësohet". Gjatë ndalesës së tij të radhës në Bruksel, Zelensky u takua me

kreun e NATO-s, Mark Rutte, presidentin e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe presidentin e Këshillit Evropian, Antonio Costa. "Ne diskutuam në detaje për punën tonë me partnerët amerikanë mbi hapat drejt paqes, garancitë e sigurisë dhe forcimin e qëndrueshmërisë sonë. Po

ashtu, biseduam për nismën PURL dhe kredinë për rindërtim", shkroi Zelensky në rrjetet sociale pas takimit në Bruksel. "Ndërsa bisedimet për paqe po vazhdojnë, BE-ja mbetet e palëkundur në mbështetjen e saj për Ukrainën. Propozimet tona për financim janë në tryezë", tha Ursula von der Leyen pas takimit me presidentin ukrainas. "Qëllimi është një Ukrainë e fortë si në fushëbetejë ashtu edhe në tryezën e negociatave", shkroi ajo në X. "Sovraniteti i Ukrainës duhet të respektohet. Siguria e Ukrainës duhet të garantohet, në plan afatgjatë, si një vijë e parë mbrojtëse për bllokun tonë", tha ajo. "Evropa duhet të vazhdojë të kontribuojë në të gjitha përpjekjet për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme për Ukrainën", përfundoi shefja e KE-së.

REPORTERËT PA KUFIJ: 67 GAZETARË U VRANË NË 12 MUAJT E FUNDIT

GAZA, 9 DHJETOR - Gjashtëdhjetë e shtatë gazetarë janë vrarë gjatë 12 muajve të fundit si pasojë e punës së tyre, u tha në raportin e ri të Reporterëve pa Kufij, organizatë që e cilësoi vitin 2025 si "vit vdekjeprurës për gazetarët". "Gazetarët thjesht nuk vdesin, ata vriten. Numri i gazetarëve të vrarë është rritur sërish për shkak të praktikave kriminale të grupeve ushtarake - si të rregullta ashtu edhe paramilitare - dhe krimit të organizuar. Të paktën 53 nga 67 profesionistë të mediave të vrarë gjatë vitit të fundit ishin viktimat të luftës apo rrjeteve kriminale", tha Reporterët pa Kufij. Sipas raportit, pothuajse 43 për qind e gazetarëve të vrarë në 12 muajt e fundit u vranë nga Gazë nga forcat e armatosura izraelite. Në Ukrainë ushtria ruse "vazhdon të shënjestrojë gazetarët ukrainas dhe të huaj", tha raportit. "Gazetarët janë më në rrezik në shtetet e tyre. Vetëm dy gazetarë të huaj u vranë gjatë



këtij viti: fotoreporterit francez Antoni Lallican, u vra nga një sulm rus me dron në Ukrainë, dhe gazetari nga Salvadori Javier Hercules, u vra në Honduras, ku po jetonte prej një dekade. Të gjithë gazetarët e tjerë të vrarë janë vrarë në shtetet e tyre", thanë Reporterët pa Kufij. Sudani, po ashtu, është shndërruar në një zonë vdekjeprurëse lufte për gazetarët. Ndërkaq, në Meksikë grupet e krimit të organizuar janë përgjegjëse për rritjen e numrit të gazetarëve të vrarë. Ky shtet,

është shteti i dytë më i rrezikshëm në botë për gazetarët, sipas Reporterëve pa Kufij, pasi aty janë vrarë nëntë gazetarë. Aktualisht 503 gazetarë janë të arrestuar në mbarë botën, ku Kina ka numrin më të lartë (121), pasuar nga Rusia (48) që ka të arrestuar më shumë gazetarë të huaj se çdo vend në botë, përfshirë 26 ukrainas. Në vendin e tretë sa i përket arrestimit të gazetarëve është Mianmari, që njihet edhe me emrin Burma. Sipas raportit, 135 gazetarë janë të zhdukur në 37 shtete të botës,

kryesisht në Lindjen e Mesme dhe Amerikë Latine. Këtu përfshihet edhe Kosova me pesë gazetarë që janë të zhdukur që nga lufta e vitit 1998-'99. Reporterët pa Kufij thanë se 20 gazetarë janë mbajtur peng, të gjithë burra. Tri shtetet që konsiderohen me rrezikshmërinë më të lartë për pengmarrje të gazetarëve janë Jemeni, që ka nëntë gazetarë që i mban peng, Siria me tetë dhe Mali dy. Sa i përket Jemenit, gazetarët janë marrë peng nga rebelët Huthi. Në raportin e këtij viti, Reporterët pa Kufij kanë përfshirë edhe sulmet fizike ndaj gazetarëve. Në këtë drejtim është përmendur edhe situata në Serbi. "Që nga fillimi i protestave kundër korrupsionit, të nxitura nga rrëzimi vdekjeprurës i strehës së një stacioni treni në nëntor të vitit 2024, profesionistët e medieve serbe që mbulojnë demonstratat janë subjekt i të paktën 98 sulmeve fizike, sipas regjistrimeve të Reporterëve pa Kufij, nga të cilat 91 kanë ndodhur që nga 1

janari 2025. Rreth gjysma e këtyre sulmeve janë kryer nga policia me pandëshkueshmëri të plotë, në një klimë të formësuar nga presidenti serb, Aleksandar Vučić, ndaj mediave. Ai ndodhet në listën tonë për vitin 2025 si një nga kërcënuesit e lirisë së shtypit", u tha në raport. Gjashtëmbëdhjetë persona janë vrarë nga shembja e strehës në Novi Sad, teksa protestuesit, të udhëhequr nga studentët që një vit po kërkojnë përgjegjësi për incidentin dhe mbajtjen e zgjedhjeve të reja. Ndryshe, më 2 maj, në prag të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, Reporterët pa Kufij publikuan indeksin vjetor për lirinë e shtypit, ku Kosova shënoi rënien më të madhe ndër vite, duke u renditur në vendin e 99-të nga 180 shtete të botës. Kosova u rendit më së keqi në zonën e Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian. Mali i Zi u rendit më së miri nga vendet e rajonit, ndërkaq Serbia u radhit në vendin e 96-të.

Turqia do të jetë garantuese për furnizimin e Hungarisë me gaz rus, thotë Orban

ANKARA, 9 DHJETOR - Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, dhe kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, janë pajtuar që Turqia të jetë garantues që gazi rus të vazhdojë të rrjedhë drejt Hungarisë, tha Orban. Hungaria e ka ruajtur varësinë e saj nga energjia ruse që prej fillimit të luftës në Ukrainë, për çfarë është përballur me kritika

nga disa aleatë të vet në Bashkimin Evropian dhe NATO. Hungaria nënshkroi marrëveshje 15-vjeçare me Rusinë në vitin 2021 për të blerë 4.5 miliardë metra kub gaz çdo vit dhe e rriti sasinë e blerjeve nga Gazprom vitin e kaluar, duke importuar rreth 7.5 miliardë metra kub gaz rus përmes tubacionit TurkStream. "Sot u pajtuam me

presidentin që ju, Turqia, do të garantoni për rrugën, në mënyrë që ne të mund ta transportojmë (gazin) nga Rusia në Hungari", tha Orban në një konferencë shtypi të transmetuar nga kanali shtetëror M1. Orban tha se Hungaria ka marrë 7.5 miliardë metra kub gaz përmes tubacionit TurkStream deri më tani këtë vit.



OVLUÇK-ja fton shqiptarët të bashkohen në protestën e 13 dhjetorit në Shkup

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka mbajtur një takim me kryetarë të degëve lidhur me përgatitjet e fundit për protestën e 13 dhjetorit e cila do të mbahet në sheshin “Skënderbeu” në Shkup. Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së ka ftuar të gjithë shqiptarët që të bashkohen në këtë protestë. “Sot, në takimin me kryetarët e degëve, u diskutua lidhur me përgatitjet e fundit për protestën e 13 dhjetorit, e cila do të mbahet në Sheshin ‘Skënderbeu’ në ora 13:00 në Shkup. Ftojmë të gjithë shqiptarët të bashkohen me ne në këtë protestë”, ka njoftuar OVLUÇK-ja. Kjo është protesta e pestë me radhë për ish-krerët e UÇK-së që po mbahen në Hagë pas atyre në Prishtinë, Hagë, Tiranë dhe Strasburg.



PËRPARIM RAMA BETOHET NË MANDATIN E DYTË KRYETAR I PRISHTINËS

EPOKA ERE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Të martën në seancën inauguruese të asamblesë së kryeqytetit, kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, mori mandatin e dytë. Ai i falënderoi qytetarët për besimin, duke rikujtuar se përgjegjësia e institucioneve është e përbashkët. Rama theksoi vendosmërinë për t’i përfunduar projektet kapitale, për t’i vazhduar investimet në arsim, shëndetësi dhe zhvillim rural, si dhe për t’i përkrahur idetë inovative të rinisë. “Prishtina foli! Ky besim është përgjegjësi dhe motiv. Ne do të punojmë me përkushtim të palëkundur për qytetin tonë”, u shpreh ai. Duke iu referuar katër viteve të fundit, Rama theksoi se bllokadat politike kanë dëmtuar qytetarët, por u bëri thirrje të gjithë asamblistëve për bashkëpunim. “Secili jemi të votuar për t’u

shërbyer qytetarëve, jo partive. Uroj që në këtë mandat të mos krijojmë bllokada artificiale, por të punojmë për të ardhmen tonë”, tha ia. Rama ritheksoi rëndësinë e punës dhe llogaridhënies së drejtorëve dhe të gjithë administratës: “Qytetarët nuk na kanë zgjedhur për t’i ushqyer egot tona, por për të punuar për ta. Unë do të jem këtu 24/7 pa ngjyra politike, pa inate e pa barriera”, tha Rama. Duke paraqitur vizionin “Prishtina përtej”, Rama ka njoftuar se një ndër projektet kyçe të mandatit do të jetë organizimi i Lojërave Olimpikë “Prishtina 2030”. “Kjo është mundësi historike për qytetin dhe për Kosovën. Duhet bashkim dhe vizion i përbashkët për brezat e rinj dhe për imazhin ndërkombëtar të Prishtinës. Ky është momenti ynë. Bashkë mund ta ndërtojmë Prishtinën e së nesërmes. Tani është koha për punë të mëdha”, përfundoi kryetari Rama.



BASHA PRITI NXËNËSIT QË PËRFAQËSUAN KOSOVËN NË 15TH BRAINOBRAIN INTERNATIONAL COMPETITION NË DUBAI



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dimal Basha, ka pritur të martën në Kuvend 21 nxënësit e Brainobrain Kosova, të cilët përfaqësuan me shumë sukses vendin tonë në 15th Brainobrain International Competition të mbajtur në Dubai. Fëmijët ishin të shoqëruar nga Adella Gjini Rodiqi, drejtoreshë e mësimi, dhe Vlora Matoshi-Shala, koordinatore në Brainobrain Kosova, si dhe nga disa prindër. Në këtë garë morën pjesë 1 810 nxënës nga 16 shtete, ndërsa ekipi i Kosovës u rikthye me rezultate të jashtëzakonshme,

duke marrë 12 trofe të vendit të parë, 7 trofe të vendit të dytë dhe dy trofe të vendit të tretë. Duke u uruar mirëseardhje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, Basha përgëzoi nxënësit për suksesin e merituar dhe i inkurajoi ta vazhdojnë rrugën e shkëlqyeshme. Këta nxënës të moshave 6-14 vjeç, që vijnë nga shkolla të ndryshme të Kosovës, garuan në një sërë sfidash që testojnë aftësi të avancuara kognitive në aritmetikë mendore me abakus, zgjidhje të shpejtë të ushtrimeve matematikore, përqendrim, memorizim, mendim logjik dhe kreativitet.

Vitia njofton për shpërndarjen edhe të tetë autoambulancave të reja nëpër komuna

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Ministri në detyrë i Shëndetësisë, Arben Vitia, ka njoftuar për shpërndarjen edhe të tetë autoambulancave të reja nëpër komuna. Ai ka bërë me dije se gjatë këtij mandati qeverisës janë shpërndarë nëpër komuna mbi 40 autoambulanca të reja. “Mbi 40 autoambulanca të reja janë siguruar gjatë këtij mandati për komunat e vendit. Po shpërndahen edhe 8 të fundit. Flota e autoambulancave sot është më moderne, më e sigurt dhe më e pajisur se asnjëherë. Shërbime më të sigurta dhe më të mira shëndetësore për të gjithë qytetarët e Republikës”, ka shkruar Vitia në “Facebook”.





OSMANI: VAZHDIMI I MASAVE TË BE-së NDAJ KOSOVËS, I PASHPJEGUESHËM DHE I PADREJTË

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se vazhdimi i masave ndëshkuese që Bashkimi Evropian ka vendosur ndaj vendit mbetet “i pashpjegueshëm, i padrejtë dhe i paarsyeshëm”. Gjatë një takimi me raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras, Osmani kërkoi mbështetjen e tij për heqjen e këtyre masave që blloku evropian i ka vendosur më 2023. Ndërkaq në një takim që ka pasur të martën ambasadori i Francës, Olivier Guerot, me kryetarin e PDK-së, Bedri Hamza, ka bërë me dije se letra e këtij të fundit për masat e BE-së ndaj Kosovës i është dorëzuar kabinetit të Macronit

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të martën në takim raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras. Në takim u diskutua për zhvillimet e fundit politike në vend, me ç'rast presidentja Osmani theksoi se zgjedhjet lokale u zhvilluan në mënyrë plotësisht të lirë, të qetë dhe demokratike dhe se transferimi i pushtetit u bë në mënyrë paqësore. Presidentja Osmani theksoi se, pavarësisht prej bashkëpunimit konstruktiv, vazhdimi i masave të BE-së ndaj Kosovës mbetet i pashpjegueshëm, i padrejtë dhe i paarsyeshëm. Në këtë kontekst, Osmani kërkoi mbështetjen e Terras për heqjen sa më të

shpejtë të këtyre masave, duke rikujtuar se ato dëmtojnë qytetarët dhe minojnë besimin në procesin e integritetit, teksa Kosova ka përmbyshur çdo kërkesë të paraqitur nga partnerët evropianë. Sipas presidentes Osmani, heqja e masave do të ishte një sinjal i fuqishëm për qytetarët dhe një mesazh inkurajues për vazhdimin e reformave. Më tej, Osmani shtroi nevojën që kërkesa e Kosovës për anëtarësim në BE të procedohet sa më parë dhe që anëtarësimi të bëhet në bazë të meritave. Gjatë takimit presidentja paraqiti një sërë të dhënash të institucioneve ndërkombëtare që e pozicionojnë Kosovën në majat e performancës në shumë fusha kyçe. BE-ja i vendosi disa masa ndëshkuese Kosovës më 2023 për shkak të rritjes së tensioneve në

veriu e vendit të banuar me shumicë serbe. Në maj të këtij viti, shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas, gjatë një vizite në Kosovë tha se blloku ka nisur heqjen graduale të këtyre masave. Ajo nuk tregoi se cilat masa janë hequr apo mund të hiqen, por Radio Evropa e Lirë atëbotë mësoi nga burimet në Bruksel se masat që janë hequr kanë të bëjnë me Marrëveshjen e Stabilizimit Asocimit (MSA), paktit të parë kontraktual mes Kosovës dhe BE-së, dhe Kornizën e Investimeve për Ballkanin Perëndimor. Gjatë takimit me raportuesin për Kosovën në PE, presidentja Osmani ka theksuar se është e nevojshme që kërkesa e vendit për anëtarësim në BE “të procedohet sa më parë dhe që anëtarësimi të bëhet në bazë të meritave”. Nga shtetet e Ballkanit

Perëndimor, vetëm Kosova është prapa në rrugën evropiane, pasi është vendi i vetëm që nuk ka as statusin e vendit kandidat. Kosova ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Megjithatë, ky aplikim ende nuk ka kaluar as në fazën e parë formale, atë të shqyrtimit nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimit për opinion në Komisionin Evropian.

Letra e Hamzës për heqjen e sanksioneve të BE-së dërgohet në kabinetin e Macronit

Kryetari i PDK-së, Bedri Hamza, ka takuar të martën ambasadorin e Francës, Olivier Guerot, duke e vlerësuar një takim të shkëlqyer. Hamza ka bërë me dije se ambasadori Guerot e ka njoftuar me letrën e tij për heqjen e të gjitha sanksioneve të BE-së se ia ka përcjellë kabinetit të presidentit Macron. “Populli i Kosovës e meriton mbështetjen, pavarësisht se kush është në qeveri. Ne biseduam edhe për nevojën e kthimit të normalitetit dhe stabilitetit në vend. Si kryeministër i ardhshëm, fokusi im do të jetë rikthimi i temave të bashkëpunimit ekonomik dhe

diplomatik me aleatët tanë”, ka shkruar Hamza në “Facebook”. Po ashtu, kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ia ka dërguar një letër zyrtare edhe presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ku kërkon heqjen e menjëhershme dhe të pakushtëzuar të masave të BE-së ndaj Kosovës. Në tekstin e letrës bie në sy një qasje që shkon përtej interesit partiak dhe zgjedhor, duke e vendosur perspektivën evropiane të Kosovës mbi çdo rivalitet politik. Në qendër të mesazhit të tij, Hamza thekson se Kosova duhet trajtuar si çdo vend tjetër i Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se sanksionet po e dëmtojnë vendin në momente kyçe për integrimin evropian dhe euroatlantik. “Vendit tonë duhet t'i jepen të njëjtat mundësi, mjete dhe mbështetje si të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt BE-së dhe NATO-s”, shkruan ai. Duke reflektuar mbi vitin sfidues që ka kaluar Kosova, me tri procese zgjedhore brenda një viti, Hamza shpjegon se këto janë dëshmi të “qëndrueshmërisë dhe pjekurisë së demokracisë së Kosovës”. Ai thotë se proceset zgjedhore janë zhvilluar

LISTAT PËR EVROPË DHE LISTAT PËR DUBRAVË!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Ngricat e 28 dhjetorit për dikën - dikën: Më në fund u bënë publike listat e partive apo koalicioneve për zgjedhjet e jashtëzakonshme të 28 dhjetorit pasi LV-ja me 48 deputetë dhe me zhagmbajtësen Vojsa Osmani, presidente në theqafje nuk arriti apo nuk dësh të formojë institucionet. U krijua një situatë e anarkisë së menaxhuar nga zyra ndërlidhëse greko “shqiptare” që udhëhiqet nga bija besnike e Zevras dhe Mataksait (oficerët grekë që shfarosën çamët), Dejona Mihali. Këtë anarki të menaxhuar mirë, në shërbim të pushtetit e keqpërdorën maksimalisht duke mos lënë gjë pa bërë, pa i nënshtruar mbikëqyrjes parlamentare, duke dhunuar brutalisht transparencën dhe llogaridhënien, si detyrime dhe vlera të shtuara të demokracisë. Mediet iu nënshtruan një përndjekjeje brutale kurse një pjesë e sektorit joqeveritar u korruptua nga grazhdi i paramilitarizimit antikombëtar Hekuran Murati ose nga dëmtuesja më e madhe e diplomacisë kosovare, Donika Shvarc. Në raste më pikante siç ishte puna me disa menderm-ethënë analistë, gazetarë, pevaçica apo artistë të Serbisë, personalisht u konvertuan nga diktatori Kurthi dhe zgjatja e tij, Hajnnullah Çeko. Gjatë këtyre zhvillimeve shkatërruese për Kosovën, opozita angazhohej për zhvillimin e demokracisë në Etiopi dhe Mongoli. LV-ja, me aktivisten më të bindur, Vojsa Osmani e kurdisën ditën dhe datën e zgjedhjeve sipas bioritmit të diktatorit Kurthi, më 28 dhjetor ndonëse shumica e propozimeve ishin për datën 21 dhjetor. Vetëm naivët kanë shpresuar se presidentja në theqafje do të përfillë

propozimet e shumicës së partive politike. LV-ja me angazhimin arrogant në KQZ u mundua të krijojë një kauzë “patriotike” kinse po e lufton Listën Serbe në kohën kur Mimoza Kusari kishte mbajtur kontakte të rregullta me Radoiçiqin dhe Simiqin në luftë kundër veteranëve të luftës dhe në përpjekje për ta ndryshuar përbërjen e Gjykatës Kushtetuese. Me “luftën” kundër Listës Serbe, LV-ja po e fyen shumë edhe robin e saj të bindur që u zgjodh presidente edhe me kontributin bujar të Listës Serbe. Kësaj situatë i kontribuoi edhe Radoniqi që është mbjell në këtë pozitë nga Kurthi dhe Osmani duke lejuar rrugaçërinë e LV-së përballë anëtarëve të tjerë. Iu nënshtruan edhe shantazhit të Donika Shvarc që të votohet edhe jashtë përfaqësive diplomatike dhe konsulare, në restorante, kafe të rakisë, shtëpia publike të njohura si pufe dhe në lokacione tjera që frekuentohen dhe kontrollohen nga LV-ja. Para se të bëhen publike listat, pati anëtarësime të “reja” të kuadrove “premtuese”. Kryesisht ishin mbetje të dështuara politike apo eksponentë që vite të tëra lobuan për partinë ku kërkuan dhe gjetën flladin apo grazhdin perspektiv. Është interesant fakti se të gjithë të konvertuarit, pa u dëshmuar fare në subjektin strehues, me automatizëm u bënë pjesë e listave zgjedhore që e vë në pah klientelizmin politik apo shantazhin, thuaja si mjet i përligjur. Pastaj një dukuri edhe më shqetësuese ku ndërthuren shumë interese e ku shantazhi ishte përcaktues është edhe riciklimi i humbësve të shumëfishtë, qoftë në zgjedhje lokale (kryesisht për kryetarë komunash) apo edhe në ato parlamentare. Madje, që ndodhë vetëm në vende të kanibalizmit politik kur ai që

pëson humbje të njëpasnjëshme shpërblehet duke u ranguar lartë. Duke hëngër koka të të tjerëve që janë edhe më të aftë, edhe mbledhës më të mirë të votave.

Të shëtisim pak nëpër lista: 1. LV-ja e ka listën më të pakualifikuar të mundshme në aspektin politik kurse thuaja 80 për qind janë antikombëtar, kundër luftës, UÇK-së dhe udhëheqësve të luftës. Ka kandidatë serioz për Dubravë, Dyç dhe burgun për femra në Lipjan. Ka dezertorë të luftës që kanë dhënë deklarata të turpshme para policisë dhe hetuesisë serbe e sot janë ministra të Kurthit, “të burgosur politikë” dhe veteranë të luftës. Dominon mendësia serbe dhe jugosllave ndërsa përcaktimi kombëtar është retorikë që pengon në karrierë. Patriotët e dikurshëm kanë shndërruar në servilë të bindur. Nuk ka ndryshim në këtë listë sepse ata që kanë dinjitet qoftë edhe minimal nuk duan të jenë nën urdhrat e andartes greke Dejona Mihalis. Kurthit i duhet pikërisht ky profil; pa integritet profesional, pa identitet kombëtar, pa skrupuj moral dhe jargavitës të dëshmuar. Që 100 për qind varen nga Kurthi. Kurthi i bënë zojë, Kurthi i bënë tojë! Ky është profil që i përshtatet votuesit të LV-së! Sa më injorant, më lehtë vjen te vota! Me të tillë Kurthi kërkon vota ...dhe edhe fiton! Nëse e analizoni 10-shen e parë, kape njërin - mëshoji tjetrit. Me përjashtim të Shqipes që ka një të kaluar kombëtare të tjerët as erë nuk marrin nga kombëtarja, janë anti UÇK-së dhe anti shtet të mjerë. Albin Kurthi e ka strategjinë e bllokimit të gatshëm nëse nuk i dalin llogaritë si ka planifikuar. E ka lënë në listë Avni Deharin me të cilin e përsërit skenarin e kaluar

të bllokimit. Kurse ky, pa fije përgjegjësie bëhet mashë e tij edhe me çmim të shkëljes së Kushtetutës siç e bëri dhjetëra herë këtë vit. I njëjti, pa fije turpi kërkon vota, merreni me mend për forcimin e shtetit. Edhe piunja e andartes greke, Lenka Haxhiu është rezervë e mekanizmit bllokues, në rast se e kërkon lideri suprem, diktatori Kurthi. LV-ja thirret në “çlirim” e veriut e në fakt ka krijuar të gjitha kushtet për ndarje të veriut duke ia dorëzuar 100 për qind pushtetin lokal Listës Serbe. Opozita ka rënë në kurthin e diskursit fyes dhe përjashtues të LV-së e që nuk është dashur të ndodhë kurrsesi. LV-ja në vijën e parë të frontit kundër opozitës ka vendosur femra pa kurrfarë të kaluar kombëtare dhe politike dhe çdo kundërpërgjigje ndaj pretendimeve të tyre është cilësuar si gjuhë seksiste dhe dhunë ndaj femrës. Pastaj kanë angazhuar anëtarë meshkuj me sjellje rrugaçësh, të padenjë edhe për Institutin Special ku sundon çlirimtari në Shtime. Votuesi i LV-së këto i do këto rrugaçëri aq më parë që kontributi i tyre politik dhe kombëtar për Kosovën është zero. Prandaj edhe votojnë agimbahtira, haxhiqamila, adrianënatoshë, dimalarsovska, besnikrrencbislima, nezirkkrakovina e të tjera llomshtina. Këta votues dhe impotencia kundërshtuese e opozitës e kanë sjellë Kosovën buzë falimentimit. 2. PDK-ja e ka listën e pastër para ligjit por disa pjesëtarë të saj bartin hipoteka nga e kaluara. Në kontekstin negativ. Prandaj edhe opozitarizmin e kanë të kushtëzuar. PDK-ja në asnjë kontekst nuk duhet të lidhet me LV-në, edhe me çmim të mbetjes në opozitë. PDK-ja ka prurje të reja por se nuk sjellin shumë vota. Votat i sjellin

“elefantët e vjetër”, pa ta nuk do të bënin asgjë. PDK-në e ka dëmtuar bukur shumë Stalingradi i Ramizit në Drenas. Arnimet e Ali Ahmetit nuk japin rezultate afatgjate, kanë efekt paliativ (zbutja e dhimbjeve para ndarjes përfundimtare). U bë përrallë puna me Nismën. Mendoj se PDK-ja nuk humbë vota shkaku i mosbërës koalicion me Nismën. Përkundrazi! PDK-ja është dashur të shkojë në zgjedhje e vetme dhe me listë burimore, jo të arnohet. PDK-ja ka një trup votues të qëndrueshëm dhe të disiplinuar për t’ju nënshtruar shantazheve të çfarëdo lloji. Partia ende duhet të krasitet, jo shkaku i formës por shkaku i përmbajtjes. Me arrestimin e liderëve që po mbahen si pengje të drejtësisë së kriminalizuar ndërkombëtare në Hagë, PDK-ja ka pësuar shok posttraumatik. Deri më tani mirë e ka përballuar. 3. LDK-ja ka një listë të respektueshme ku përfshihet dhe përfaqësohet i tërë kapaciteti njerëzor dhe njerëzor për udhëheqje të vendit. Është një bashkëdyzim i përvojës dhe ambicies së bazuar. LDK-ja duhet të punojë më shumë me votuesit, të merret me përmbajtjen e jo me dukjen apo paraqitjen. Gjatë fushatës duhet të përqendrohet më shumë në luftë kundër mafies energjetike në krye oligarkët Kurthi, Berishaj, Rizvanolli dhe Murati, midis shumë të tjerëve. 4. AAK-ja ka bërë një listë që ngjall respekt dhe siguron vota. Më në fund iu ra ndërmend se Besnik Tahiri është vlerë e shtuar politike prandaj e renditën si dyshi i AAK-së në listën për deputetë. **Rezultati po të mbaheshin zgjedhjet më 14 dhjetor 2025: LV-ja 36 - 39 deputetë, PDK-ja 25 - 28 deputetë, LDK-ja 22 - 25 deputetë dhe AAK-ja 7 - 10 deputetë.**

“demokratikisht, me transparencë dhe paqësisht”, pavarësisht bllokadës së mëvonshme politike. Në letërën e tij, Hamza risjell në vëmendje sakrificat dhe obligimet që Kosova ka marrë përsipër në rrugën e integritetit, përfshirë edhe krijimin e Dhomave të Specializuara. Ai e

quan këtë një kërkesë të imponuar vetëm mbi Kosovën, e cila, “fatkeqësisht, është shndërruar në një instrument monoetnik”. Por, pjesa më shprehëse e letrës është thirrja e tij për unitet dhe qasje të përbashkët shtetërore ndaj interesave strategjike. “Pavarësisht se kush do t’i

udhëheqë institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve, vendi ynë duhet të ketë të njëjtat mjete dhe mbështetje si të gjitha të tjerat në rajon. Vazhdimi i masave e privon Kosovën nga këto mundësi dhe rrezikon t’i minojë vlerat demokratike dhe pro-evropiane”. Kjo fjali e përmbledh filozofinë e

letrës: çështja e sanksioneve nuk është e një qeverie apo partie, por e vetë shtetit të Kosovës. Në përmbyllje, Hamza i bën thirrje BE-së të dërgojë një sinjal të fortë mbështetjeje ndaj qytetarëve të Kosovës, duke kërkuar vendimin që do t’i hapte rrugë një faze të re të marrëdhënieve. “Kërkoj me

respekt heqjen e menjëhershme dhe të pakushtëzuar të të gjitha masave të BE-së ndaj Kosovës”. Letra reflekton një pozicion që Hamza e paraqet jo vetëm si lider partie, por edhe si një figurë burrështetasi që synon stabilitet, partneritet dhe trajtim të drejtë të Kosovës në proceset euroatlantike.

Fakulteti Juridik forcon bashkëpunimin me institucionet e drejtësisë

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Përfaqësues të Fakultetit Juridik të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë priten në takim kryeprokuroren e Prokurorisë Themelore në Pejë, Lumturie Vuçetaj, si dhe përfaqësuesit e organizatës Lëvizja FOL. Takimi u zhvillua në kuadër të projektit "Ngritja e vetëdijes dhe besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë", i mbështetur nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe kishte për qëllim realizimin e panelit informues "FOL hapur mbi qasjen në drejtësi" me studentët e Fakultetit Juridik.

Prodekani i Fakultetit Juridik, prof. Mensur Morina, e hapi takimin duke u uruar

mirëseardhje panelistëve dhe duke theksuar rëndësinë e këtyre bashkëpunimeve për avancimin e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin profesional të studentëve dhe forcimin e lidhjes ndërmjet fakultetit dhe institucioneve të drejtësisë. Ai potencoi se ky aktivitet është plotësisht në harmoni me strategjinë e Fakultetit Juridik dhe UHZ-së, sidomos në fushën e bashkëpunimit me industrinë dhe institucionet publike.

Në fjalën e saj, kryeprokuroja Vuçetaj paraqiti funksionimin e sistemit prokurorial, rolin dhe përgjegjësitë e prokurorëve, si dhe sfidat që lidhen me qasjen në drejtësi. Ajo theksoi se

bashkëpunimi me Fakultetin Juridik të UHZ-së është shumë i frytshëm, duke vlerësuar lart angazhimin dhe performancën e studentëve gjatë praktikave në Prokurorinë Themelore në Pejë. Panelisti prof. Orhan Çeku foli për rëndësinë e ndërthurjes së teorisë me praktikën dhe për kontributin që Klinika Juridike jep në përgatitjen profesionale të studentëve, përfshirë edhe klinikën reale, e cila u mundëson atyre të punojnë me raste konkrete nën monitorimin e profesionistëve të fushës.

Një fjalë rasti mbajti edhe zëdhënësi i Prokurorisë Themelore në Pejë, Nikçi, i cili inkurajoi studentët të



shfrytëzojnë çdo mundësi pjesëmarrjeje në aktivitete të tilla, pasi ato u ofrojnë përvojë, njohuri dhe perspektiva reale profesionale.

Ngjarja u përmbyll me një sesion pyetje - përgjigjesh, ku

studentët patën mundësinë të diskutojnë drejtpërdrejt me panelistët dhe të marrin sqarime mbi çështje të ndryshme që lidhen me qasjen në drejtësi dhe funksionimin e sistemit prokurorial.

ZGJEDHJET E 28 DHJETORIT 2025: TESTI VENDIMTAR PËR KONSOLIDIMIN E SHTETIT TË KOSOVËS



Prof. dr. Fejzulla BERISHA

Kosova përballë një prove vendimtare shtetërore

Zgjedhjet e 28 dhjetorit 2025 përfaqësojnë shumë më tepër sesa një proces të rregullt elektoral. Ato përbëjnë një provë të rëndësishme politike, institucionale dhe morale për Republikën e Kosovës, në një fazë delikate të konsolidimit të saj shtetëror. Në thelb, qytetarët përballen me një dilemë

thelbësore: forcimin e një shteti funksional, të bazuar në ligj, profesionalizëm dhe përgjegjësi publike, apo vazhdimin e një praktike qeverisëse të karakterizuar nga improvizimi politik, diletantizmi institucional dhe personalizimi i pushtetit.

Kur diletantizmi politik institucionalizohet

Sfida kryesore e Kosovës nuk lidhet me mungesën e kornizës ligjore apo institucionale, por me mënyrën se si pushteti është ushtruar në praktikë. Në shumë

raste, qeverisja është perceptuar dhe trajtuar jo si shërbim ndaj interesit publik, por si instrument për realizimin e interesave personale apo partiake. Ky realitet ka mundësuar shndërrimin e diletantizmit politik, në bashkëpunim me klientelizmin dhe kapjen e institucioneve, në një model funksional të ushtrimit të pushtetit.

Si pasojë, antivlerat janë normalizuar, ndërsa standardet profesionale dhe meritokracia janë marginalizuar, duke e dobësuar ndjeshëm efektivitetin dhe besueshmërinë e institucioneve publike.

Antivlerat si kërcënim për integritetin shtetëror

Në praktikën e shteteve me demokraci të konsoliduar, korrupsioni moral dhe institucional konsiderohet një kërcënim serioz për sigurinë dhe stabilitetin kombëtar. Në rastin e Kosovës, tolerimi i zgjatur i praktikave të tilla ka krijuar një proces degenerues, që vepron gradualisht mbi themelet e shtetit. Mosndëshkimi i vazhdueshëm i këtyre dukurive ka minuar besimin e qytetarëve në institucione dhe ka thelluar distancën ndërmjet aparatit

shtetëror dhe shoqërisë.

Shtetet e vogla dhe pamundësia për të toleruar antivlerat

Përvoja ndërkombëtare tregon qartë se shtetet e vogla dhe të reja nuk e përballojnë dot luksin e institucioneve të dobëta dhe qeverisjes joprofesionale. Modele si Finlanda, Estonia dhe Singapori dëshmojnë se suksesi shtetëror nuk është produkt i retorikës politike, por i ndërtimit sistematik të institucioneve të forta, të bazuara në meritokraci, kompetencë dhe respekt ndaj ekspertizës.

Roli i elitës intelektuale dhe përgjegjësia publike

Elita intelektuale dhe akademike - profesorët, studiuesit, juristët, ekonomistët dhe profesionistët e fushave strategjike - përbëjnë një nga shtyllat themelore të zhvillimit shtetëror. Heshtja e tyre në raport me deformimet institucionale krijon një boshllëk të rrezikshëm, i cili shpesh mbushet nga mediokriteti politik. Historia evropiane dhe praktika demokratike dëshmojnë se reformat e qëndrueshme nisin

nga mendimi kritik dhe angazhimi akademik, jo nga propaganda ose improvizimi politik.

28 dhjetori 2025: Zgjedhje për shtetin dhe rendin institucional

Zgjedhjet e ardhshme paraqesin një moment vendimtar për vetëdijen qytetare. Ato janë një mundësi për të zgjedhur mes forcimit të një shteti funksional, të bazuar në standarde morale dhe profesionale, dhe vazhdimin të një modeli qeverisjeje të dominuar nga personalizimi i pushtetit dhe servilizmi politik.

Kosova nuk ka nevojë për figura të rastësishme apo për qasje populiste ndaj pushtetit. Ajo ka nevojë për lidhshmëri të përgjegjshme, me kompetencë profesionale, integritet moral dhe vizion shtetëror. E ardhmja e Republikës së Kosovës ndërtohet mbi meritokraci, forcim institucional dhe respekt ndaj parimeve të qeverisjes së mirë, jo mbi narcisizëm politik dhe improvizim.

Përvoja historike e dëshmon në mënyrë të qartë: shtetet e vogla mbijetojnë dhe zhvillohen vetëm kur udhëhiqen nga elita e përgjegjshme dhe profesionale.

Lansohet platforma Integrity Watch Kosova

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Në mesin e shumë kolegëve nga shoqëria civile, institucioneve publike, komunitetit diplomatik, donatorëve, gazetarëve dhe adhuresve të të dhënave, në prag të Ditës Ndërkombëtare Kundër Korrupsionit, është lansuar platforma "Integrity Watch Kosova", një platformë

digjitale ku të dhënat e prokurimit publik, deklarimit të pasurisë dhe financimit politik marrin zë dhe bëhen bashkë për të treguar për integritetin në politikë.

Në hapje të ngjarjes, Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i KDI-së, Nicola Scaramuzzo, udhëheqës i ekipit për Sundimin

e Ligjit dhe të Drejtat e Njeriut dhe Yll Buleshkaj, drejtor i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, theksuan rëndësinë e platformës. Ndërsa Diana Metushi-Krasniqi, hulumtuese e lartë në KDI, shpallosi platformën para të pranishmëve, "Navigo, mëso, zbulo dhe kërko llogari".



MOSRESPEKTIMI I PROTOKOLLEVE NË QKUK RRIT INFEKSIONET

Shkelja e protokolleve të higjienës në QKUK po i ekspozon pacientët ndaj infeksioneve brendaspitalore, që në disa klinika prekin deri në 70 % të të shtruarve. Familjarët që zëvendësojnë infermierët dhe stafi i pamjaftueshëm duket se e kanë shndërruar spitalin në një ambient të pambrojtur nga bakteret dhe viruset. Problemi, megjithatë, nuk është i izoluar vetëm në Kosovë. Sipas OBSH-së, mesatarisht 1 në 10 pacientë preket nga këto infeksione

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Dy pacientë kanë humbur jetën brenda më pak se një muaji në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK). Familjarët e tyre pretendojnë se shkak nuk ishte vetëm sëmundja, por infeksionet që i morën pikërisht aty ku kërkuan shërim.

Në njërin prej rasteve pacienti me kancer ishte në gjendje stabile deri në momentin kur, sipas familjarëve, u infektua me një bakter brenda QKUK-së. “Kjo më pas i shkaktoi sepsë”, thotë shkurtimisht për Radion Evropa e Lirë një i afërm që kërkon të mbetet anonim.

Përkundër përpjekjeve, REL-i nuk arriti të merrte një konfirmim nga mjekët sepse, sipas tyre, infeksionet brendaspitalore vështirë dokumentohen në mënyrë të saktë. Këto, megjithatë, nuk janë raste të izoluar. Në hapësirat e QKUK-së rreziku i padukshëm i infeksioneve brendaspitalore kanos vazhdimisht pacientët.

Radio Evropa e Lirë ka siguruar të dhëna shqetësuese nga dy klinika: në Qendrën e Mjekimit Intensiv infeksionet brendaspitalore kanë prekur mbi 70 % të pacientëve gjatë disa muajve të këtij viti, ndërsa në Neonatologji, ku trajtohen foshnjat më të brishta, përqindja ka kaluar 20.

Drejtori i Klinikës së Anesteziologjisë dhe Mjekimit Intensiv, Gazmend Spahiu, e pranon hapur problemin: “Njësia Intensive ka përqindjen më të lartë të infeksioneve për shkak të gjendjes së rëndë të pacientëve që shtrihen aty”. Ai thotë se janë marrë disa masa të reja teknike për zvogëlimin e infeksioneve të rrugëve respiratore, si: pajisje të mbyllura për aspirim, tubusa me aspirim subglotik, higjienë më rigorozë, por pranon se mungesa e infermierëve e dobëson çdo përpjekje.

Mendim të ngjashëm shpreh edhe drejtori i Klinikës Torakale, Nazmi Kolgeci. “Ne si personel kemi kujdes dhe marrim masa preventive kundër infeksioneve. Ato nuk i bartin as pacientët, por shoqëruesit e tyre”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Prania e shoqëruesve është shndërruar në pjesë të kulturës së QKUK-së, pasi mungesa e stafit mjekësor, e sidomos infermierëve, e ka bërë të



pamundur që shumë shërbime bazë të ofrohen nga vetë spitali. Për këtë arsye, familjarët shpesh bëjnë punët që duhet t'i bëjnë infermierët - qoftë të kujdesen për higjienën e pacientit, t'i japin ushqim apo ta transportojnë për analiza.

Për pasojë, dhomat dhe korridoret e spitalit janë të mbushura me familjarë që hyjnë e dalin pa kontroll higjienik, duke e kthyer institucionin në një hapësirë të pambrojtur nga infeksionet.

Klinika Torakale është ndër të paktat në QKUK që ka një dhomë të posaçme izolimi.

Në derën e dhomës numër 234 shkruan: “Kujdes! Dhomë Septike - Infeksion”. Brenda saj paraditen e 4 dhjetorit ishin tre pacientë të sëmurë rëndë, të ndarë nga të tjerët, me mjekë e infermierë që hynin vetëm me pajisje mbrojtëse.

Në dhomën pranë, atë ditë, ishte edhe G. Paçarizi. I shtruar për një sëmundje të mushkërive, ai i tha REL-it se është prekur edhe nga një virus që mjekët nuk e kanë identifikuar ende.

Në dhomën e tij familjarët lëviznin lirshëm - pa doreza, pa maska dhe pa ndonjë kontroll. Por, këto shkelje të supozuara të protokollit nuk i bënin vetëm ata.

REL-i vëzhgoi edhe mjekë e infermierë që dilnin jashtë

klinikave me uniforma spitalore, ecnin nëpër oborr, shkonin në kuzhinën disa metra larg dhe më pas ktheheshin në hapësirat e trajtimit, pa u ndërruar.

Zyrtarë të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Klinik dhe Universitar të Kosovës - institucionit që mbikëqyr QKUK-në - pranuan shkurtimisht se “kodi i veshjes nuk respektohet”.

E nga Ekipi për Kontrollin e Infeksioneve brenda QKUK-së thanë se kanë evidentuar shkelje pothuajse në të gjitha klinikat: thonj të gjatë, stoli, uniforma të papërshtatshme - elemente këto të ndaluara me çdo standard të kontrollit të infeksioneve.

Pjesëtarë të këtij ekipi, që folën në kushte anonimiteti për Radion Evropa e Lirë, thanë se shkelësit më të mëdhenj “janë kryeinfermieret dhe mjekët”.

REL-i kërkoi për disa ditë raportin e këtij ekipi dhe përgjigje nga shefja e tij, Hatixhe Gashi. Edhe pse ajo tha se i ka dërguar ato te drejtorja e QKUK-së, kjo e fundit u përgjigj vetëm me një deklaratë të përgjithshme: “Ekipi kryen inspektim dhe monitorim të përditshëm në të gjitha klinikat e QKUK-së. Infeksionet më të shpeshta janë ato të rrugëve respiratore, si pneumonitë ventilatore”. “Pas çdo hulumtimi që bëhet, me qëllim të verifikimit

të gjendjes higjienike, merren mostrat dhe në bazë të rezultateve, merren masat e duhura në bashkëpunim me klinikat përkatëse dhe institucionet e tjera”, thuhet në përgjigje - pa ndonjë detaj më shumë.

Raportet e mëparshme të këtij ekipi kanë evidentuar deri në 600 raste të infektiveve brendaspitalore brenda një viti dhe ato kanë shkuar, kryesisht, duke u rritur. Sipas ShSKUK-së, numri i pacientëve të shtrirë në klinikat e QKUK-së dhe në spitalet e përgjithshme ka kaluar 162 mijë në vitin 2024.

Rekomandimet e vazhdueshme të Ekipit për Kontrollin e Infeksioneve përfshijnë: rritjen e nivelit të higjienës, klimatizimin qendror në salla të operacionit dhe menaxhimin e mbeturinave sipas standardeve.

Inspektorati Sanitar i Ministrisë së Shëndetësisë konfirmon për Radion Evropa e Lirë se po zhvillon disa kontrole lidhur me infeksionet brendaspitalore - madje disa raste janë edhe duke u riinspektuar. “Jemi në fazën e inspektimit dhe pasi ta kryejmë këtë punë do të përgatisim një raport”, thotë udhëheqësi i departamentit, Ibrahim Tërshnjaku.

Naser Gjonbalaj nga Oda e Mjekëve të Kosovës e përkufizon situatën me një fjali: “Vetë fakti që në vitin 2025 ende flasim për

infeksione brendaspitalore, është shqetësues”. Ai shton se mungesa e stafit, mungesa e shërbimeve cilësore dhe prania e shoqëruesve në çdo hap të spitalit janë ndër shkaktarët kryesorë të përhapjes së infeksioneve që mund të çojnë edhe në sepsë.

Pavarësisht kësaj, QKUK-ja nuk mban statistika të sakta për numrin e vdekjeve të lidhura me këtë komplikim.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, infeksionet e marra gjatë trajtimit shëndetësor janë ndër problemet më të shpeshta që ndodhin brenda spitaleve, pothuajse kudo në botë.

Mesatarisht, 1 në 10 pacientë preket nga këto infeksione.

Në vendet me të ardhura të ulëta ose të mesme, si dhe te pacientët më të rrezikuar - sidomos ata në kujdes intensiv - kjo përqindje është edhe më e lartë, sipas OBSH-së. Por, brenda QKUK-së në Prishtinë, infeksionet e tilla janë vetëm një prej shumë problemeve.

REL-i ka dokumentuar vazhdimisht sfida brenda institucionit: mungesë të mjekëve dhe infermierëve në shumë klinika; lista pritjesh që zgjasin me vite; familjarë që detyrohen ta marrin rolin e infermierëve; dhe kushte bazike që mungojnë - nga çarçafët deri te sapunët.

Kompania e Materieve të Rrezikshme përfundon trajnimin për pajisjet e pastrimit të ujit të kontaminuar

Prishtinë, 9 dhjetor - Pajisja për pastrimin e ujit (WTC-3000 GT) është e dizajnuar për trajtim dhe shpërndarje të ujit në rast të kontaminimit të tij nga ndonjë fatkeqësi natyrore

apo njerëzore, me ç'rast uji kontaminohet dhe nuk është i sigurt për përdorim. Kjo pajisje ka kapacitet të bëjë trajtimin e ujit deri në 3 000 litra në orë. WTC-3000 GT

funksionon duke aplikuar presion të lartë mbi ujin e kontaminuar, i cili kalon nëpër membrana selektive përmes procesit të osmozës reverse. Këto membrana

lejojnë vetëm molekulat e ujit të depërtojnë, ndërsa bllokojnë kripërat, metalet dhe ndotësit e tjerë, duke siguruar prodhim të ujit të pastër dhe të sigurt.



Më shumë vizitorë në hotele në tetor 2025 sesa një vit më parë

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikën e hotelierisë për muajin tetor 2025. Në tetor 2025 numri i vizitorëve (vëndorë dhe të huaj) në hotele ishte 60 737, prej tyre 40,2 % ishin vëndorë dhe 59,7 % ishin të jashtëm. Krahësuar me muajin tetor të

vitit 2024 (sa ishin 57 568 vizitorë) pati rritje të numrit të përgjithshëm të vizitorëve në hotele për 5,5 %. Numri i net-qëndrimeve ishte 142 672, prej tyre 48,1 % nga vëndorët dhe 51,9 % nga të huajt. Numrin më të madh të vizitorëve të brendshëm në hotele e ka rajoni i Pejës me 7 878 vizitorë

dhe me 29 160 net-qëndrime. Sa iu përket vizitorëve të huaj, krahasuar me periudhën paraprake (tetor 2024), në tetor 2025 pati rritje të vizitorëve për 5,2 %. Në total, 36 283 vizitorë të huaj, nga të cilët numri më i madh ishte nga: Shqipëria, Gjermania, Zvicra, Turqia etj.



AKTAKUZË NDAJ TRE PERSONAVE PËR SHPËRTHIMIN NË IBËR-LEPENC

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Prokuroria Speciale e Kosovës ka ngritur aktakuzë ndaj tre personave për shpërthimin në kanalën e Ibër-Lepencit më 29 nëntor 2024. Sipas njoftimit, J. V., D. V. dhe I. D. akuzohen për veprat penale të “rrezikimit të rendit kushtetues me shkatërrimin apo dëmtimin e instalimeve dhe pajisjeve publike, “kryerjes së veprës terroriste”, “armëmbajtjes pa leje” dhe “spiunazhit”. Aktakuza thotë se J. V. dhe D. V., së bashku me persona ende të panjohur, “pas një marrëveshje paraprake, kanë vendosur eksploziv [rreth 20 kilogramë të llojit Trinitrotoluene ‘TNT’] në brendësi të kanalit”. “J. V. dhe D. V. akuzohen se lëndën shpërthyesë e kanë aktivizuar përmes një çante të cilën e kishin lidhur me litar në një shtyllë betoni, ku si pasojë është dëmtuar rëndë struktura e betonit të kanalit Ibër-Lepenc, është shkaktuar ndërprerje e furnizimit me ujë të pijshëm, është rrezikuar prodhimi i energjisë elektrike dhe ndërmarrjes Ibër-Lepenc i është shkaktuar dëm në vlerë prej 376,774.70 eurosh”, u tha në njoftimin për medie. Prokuroria Speciale tha se J. V. Akuzohet, po ashtu, për spiunazh pasi, sipas saj, ai deri në momentin e arrestimit, “në cilësinë e të rekrutuarit në



Shërbimin Informativ Ushtarak të Serbisë, kolonel, ka vepruar dhe e ka ndihmuar këtë shërbim, duke mbledhur informacione dhe dokumente të klasifikuara me qëllim që të njëjtat ti përdor gjatë aktivitetit të tij të kundërligjshëm në territorin e Kosovës”. Hetimi për këtë rast, sipas Prokurorisë, u krye në

bashkëpunim me partnerët evropianë. Lidhur me shpërthimin autoritetet kishin arrestuar dhjetëra persona të dyshuar dhe kishin sekuestruar armë dhe eksplozivë. Por, deri më tani dihej se për këtë rast ishin dërguar në paraburgim vëllezërit Dragisha dhe Jovan Viçentijeviq, që janë dy nga tre të

akuzuarit. Pas shpërthimit në Varragë të Zubin Potokut, autoritetet në Kosovë e fajësuan Serbinë për rastin, por Beogradi i mohoi akuzat. Kosova e konsideron shpërthimin në kanalën e Ibër-Lepencit akt terrorist. Pas shpërthimit, Shtetet e Bashkuara tha se nuk kishte

prova që e lidhnin drejtpërdrejt Beogradin me shpërthimin, por se ishte herët për nxjerrjen e përfundimeve. ShBA-ja atëbotë tha se në hetime ishin përfshirë edhe agjentët e Byros Federale të Hetimit (FBI). Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenc furnizon me ujë disa qytete të Kosovës dhe Korporata Energjetike e Kosovës për ftohjen e termoelektranave të saj. Kjo ndërmarrje është në pronësi të plotë të Qeverisë së Kosovës.

Çfarë është Ibër-Lepenci?

Ndërmarrja Hidroekonomike Ibër-Lepenc, me seli në Prishtinë, është një ndërmarrje që furnizon me ujë të papërpunuar industrinë, ujësjellësit dhe bujqësinë, si dhe prodhon energji elektrike nga hidrocentrali i Ujmanit. Sipas faqes zyrtare të kësaj ndërmarrjeje, kompania është themeluar me vendim të Kuvendit të Kosovës më 28 shkurt 1967. Ndërtimi i këtij sistemi u bë në dy faza: Faza e Ibrit, e cila përfundoi më 1986, dhe faza e Lepencit, e cila nuk u realizua. Kjo ndërmarrje sot është shoqëri aksionare, 100 % në pronësi të Qeverisë së Kosovës.

DELEGACIONI I BQK-SË REALIZON VIZITË ZYRTARE NË BANKËN E ITALISË NË KUADËR TË ZBATIMIT TË PROCESIT SREP



PRISHTINË, 9 DHJETOR - Një delegacion i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK) ka zhvilluar vizitë zyrtare në Bankën e Italisë (Banca d'Italia), me fokus shkëmbimin profesional dhe avancimin e praktikave mbikëqyrëse në kuadër të Supervisory Review and Evaluation Process (SREP),

metodologji standarde e Bashkimit Evropian për vlerësimin gjithëpërfshirës të institucioneve bankare. Gjatë vizitës zyrtarë të BQK-së zhvilluan takime pune me ekspertët homologë të Bankës të Italisë, duke diskutuar mbi qasjet, metodologjinë dhe praktikën më të avancuar të zbatimit të SREP-

it. Përfaqësuesit e BQK-së vlerësuan lart gatishmërinë e zyrtarëve nga Banca d'Italia, duke theksuar se shkëmbime të tilla kontribuojnë drejtpërdrejt në forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe zbatimin e standardeve evropiane në sistemin bankar të Republikës së Kosovës.

Kurti: Nga 1 janari paga minimale bëhet 425 euro


PRISHTINË, 9 DHJETOR - Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka thënë se nga janari i vitit të ardhshëm paga minimale në Kosovë bëhet 425 euro bruto, nga 350 euro

sa është tash. “Nga muaji i ardhshëm paga minimale bëhet 425 euro bruto nga 350 euro sa është tash. Kurse nga 1 korriku fillon zbatimi i fazës së dytë ku paga minimale bëhet

500 euro, siç edhe e kemi paraparë me vendimin që kemi marrë si Qeveri. Rreth 150 mijë punëtorë të sektorit privat do të përfitojnë nga kjo rritje. Pagën minimale e

gjetëm 130/170 euro, të pandryshuar për më shumë një dekadë, dhe brenda një mandati po e rrisim për të tretën herë”, ka shkruar Kurti në “Facebook”.





FIFA me një rregull të ri për Kupën e Botës

Paris, 9 dhjetor - Na ndajnë vetëm 7 muaj nga fillimi i Kampionatit Botëror 2026. Kompeticioni më i rëndësishëm në futboll këtë herë zhvillohet për herë të parë në 3 shtete, ShBA,

Kanada dhe Meksikë si dhe do të jetë i pari me 48 shtete pjesëmarrëse. Lojtarët dhe trajnerët, po ashtu, kanë shprehur shqetësimet e tyre për shkak të temperaturave të

larta të verës në ShBA dhe Meksikë. Kjo ka rastisur edhe në Botërorin e Klubeve, ku klubet bënin një pauzë të shkurtër hidratimi. Por, FIFA ka vendosur ta implementojë

një rregull të ri ku në çdo ndeshje do të ketë pauzë 3 minutëshe në të dyja pjesët. Kujtojmë se Kupa e Botës nis më 11 qershor dhe përfundon më 19 korrik të vitit 2026.



FIFA ARENA TASHMË EDHE NË KOSOVË

PRISHTINË, 9 DHJETOR - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka thënë se me mbështetjen e FIFA-s dhe të FFK-së është duke u ndërtuar një arenë moderne sportive për komunitetin në Shkollën Fillore "Gjergj Fishta" në Prishtinë dhe "Hasan Prishtina".

"Me kënaqësi ju informoj se projekti 'FIFA Arena', një donacion i çmuar nga FIFA, me qëllim masovizimin e futbollit dhe krijimin e më shumë mundësive për fëmijët tanë, ka nisur zbatimin e tij në komunën e Prishtinës. Dy shkollat e para të përgjdhura në kuadër të këtij projekti janë: 'Gjergj Fishta' dhe 'Hasan Prishtina', ka njoftuar Ademi.

Ai ka thënë se këto fusha moderne sportive janë të dedikuara për nxënësit e shkollave dhe për komunitetin përreth, duke krijuar hapësira të reja cilësore për lojë, aktivitet fizik dhe zhvillim të talentit. "Fushat janë donacion i FIFA-s dhe instalimi i tyre është duke u realizuar në bashkëpunim të plotë me komunën e Prishtinës. Tërë procesi i furnizimit dhe montimit është i organizuar tërësisht nga FIFA. Njëra fushë tashmë është e përfunduar, ndërsa tjetra përfundon brenda kësaj jave. Në emër të KE të FFK-së dhe komunitetit të futbollit e falënderoj sinqerisht FIFA-n për këtë kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e futbollit në Kosovë. Ky projekt do të vazhdojë të




zgjerohet në shtatë regionet e tjera të vendit tonë, duke krijuar më shumë hapësira për fëmijët dhe komunitetin që të luajnë futboll dhe njëherësh ta zbulojnë talentin e tyre", ka thënë Ademi, duke shtuar se

trajnerët do të jenë të pranishëm në këto fusha. "Trajnerët tanë do të jenë të pranishëm në këto fusha, me qëllim identifikimin dhe orientimin e talenteve të rinj drejt klubeve dhe shkollave të

futbollit. Ky projekt është pjesë e programit të FFK-së për masovizimin e futbollit në Republikën e Kosovës dhe për krijimin e kushteve sa më të mira për gjeneratat e reja", është shprehur Ademi.

CLUJ PRITET TA SHESË LINDON EMËRLLAHUN TE POLISSYA



CLUJ-NAPOCA, 9 DHJETOR - Mesfushori i Kombëtares së Kosovës, Lindon Emërllahu, do të jetë largimi i parë nga skuadra e Clujit në afatin kalimtar të dimrit. Në fakt, është thënë se Cluj tashmë ka arritur marrëveshje për shitjen e Emërllahut, i cili është pajtuar të

transferohet në kampionatin e Ukrainës. Sipas medieve në Rumani, Emërllahu do të transferohet te Polissya Zhytomyr, ekip që ka pranuar t'i pagujë Clujit 1.5 milion euro për kartonin e mesfushorit 23-vjeçar. Krahas shumës prej 1.5 milion

eurosh Cluji do t'i ketë edhe 10 për qind nga shitja e ardhshme e Emërllahut, i cili iu bashkua klubit rumun në fillim të këtij viti. Plissya Zhytomyr është në pozitën e tretë në Ukrainë dhe po e sheh Emërllahun si përforcim të rëndësishëm për mesfushën, duke pasur parasysh se këtë

sezon ka shënuar 4 gola dhe ka bërë 2 asistime në 23 paraqitje për Clujin. Emërllahu ka kontratë deri në vitin 2028 me Clujin, ekip që e transferoi nga Ballkani i Suharekës. Gjithashtu, Emërllahu ka edhe 12 paraqitje dhe 1 gol të shënuar me fanellën e Kombëtares së Kosovës.

MESSI EMËRON PESË KOMBËTARET QË MUND TA FITOJNË KUPËN E BOTËS, INJORON PORTUGALINË

MIAMI, 9 DHJETOR - Kombëtarja e Argjentinës do të luftojë për ta mbrojtur titullin e Kupës së Botës në vitin 2026 që do të zhvillohet në Shtetet e Bashkuara, Meksikë dhe Kanada. Edhe pse kapiteni Lionel Messi nuk e ka konfirmuar ende nëse do të luajë në kampionatin botëror. Ai ka zbuluar favoritët e tij për ta

fituar trofeun. Pas shortit për grupet e Kupës së Botës 2026, ku do të marrin pjesë 48 ekipe për herë të parë, kanë filluar analizat dhe parashikimet rreth fituesit të mundshëm. Ylli i Inter Miamit ka ndarë gjithashtu mendimin e tij, i cili, përveç Argjentinës, për të cilën tha se do të "luftojë" për ta mbrojtur titullin, ka edhe



kandidatë të tjerë. "Ka skuadra shumë të mira. Spanja, Franca, Anglia, Brazili, të cilat gjithashtu nuk kanë qenë kampionë për një kohë të gjatë, duan ta fitojnë turneun. Gjermania, e cila gjithmonë ka dashur ta mposhtë Argjentinën, tani e dëshiron atë edhe më shumë pas Kupës së Botës së fundit. Do të jetë shumë e vështirë, por nuk kam dyshim

se ata do të luftojnë për titullin", ka thënë Messi në një intervistë për "ESPN". Në Kupën e parë të Botës me 48 ekipe, ekipet janë ndarë në 12 grupe me nga katër ekipe. Dy ekipet e para nga secili grup avancojnë në fazën eliminatore, të cilave iu bashkohen edhe tetë ekipet më të mira të vendeve të treta.

Suarezi drejt largimit nga Inter Miami


MIAMI, 9 DHJETOR - Luis Suarez me gjasë do të jetë largimi i radhës tek Inter Miami. Uruguaiiani, i cili ishte një nga figurat kryesore të

skuadrës rozë, pritët që të largohet pasi nuk do ta vazhdojë kontratën. Sipas raportimeve të medieve botërore, Suarez me gjasë do

të rikthehet në vendlindje, më saktësisht tek ish-skuadra e tij Nacional. "El Pistolero" kishte një sezon spektakolar, i cili është

shpallur edhe kampion i MLS për vitin 2025. Suarez me gjasë do të largohet nga Inter Miami me gjasë do të rikthehet në vendlindje, më saktësisht tek ish-skuadra e tij Nacional. "El Pistolero" kishte një sezon spektakolar, i cili është





Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898
Sallon Depilimi Lume's Details
lumesdetails
Mbresa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Galeria Studio” Sh. P. K. me seli në Lipjan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 811882390 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Galeria Studio” D. O. O. od Ljipjan, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811882390 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Galeria Studio” L. L. C. with headquarters Lipjan, has come to the decision to quit its business: 811882390 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjeje PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjeje Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjejepuneshpejte



RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Arber Bislimaj shpall të pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.
- Liridona Cikaci shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I – IX sh.f.m.u. “Dy Dëshmorët” Pirane.
- Egzona Gegollaj Collaku shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - IX shfmu Pjeter Budi” Lubizhd e Hasit.
- Deli Gegollaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I - IX sh.f.m.u. “Pjeter Budi” Lubizhd e Hasit.
- Istref Hysni Nebiu shpall të pavlefshme Diplomën e Inxhinier i Diplomuar i Makineris në UB-me nr. 332.
- Shkendije Lushaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.l.m.”Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.
- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

